



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

GJYKATA KUSHTETUESE
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KODI I MIRËSJELLJES PËR GJYQTARË

PREAMBULA

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke kuptuar përgjegjësitë e rëndësishme që Kushtetuta e Republikës së Kosovës ia ka besuar Gjykatës, miraton këto parime për të udhëzuar dhe për të rregulluar sjelljen e gjyqtarëve.

Qëllimi i këtyre parimeve është që të ruhet dhe të përmirësohet besimi i qytetarëve në pavarësinë dhe në paanshmërinë e Gjykatës dhe që gjyqtarëve t'u ofrohen udhëzime për ushtrimin e përgjegjësisë të tyre.

I. PAVARËSIA

- 1.1 Gjyqtarët duhet të jenë të pavarur në ushtrimin e të gjitha funksioneve gjyqësore dhe nuk duhet të lejojnë që ndonjë ndikim i pahijshëm, i jashtëm apo i brendshëm, të ndikojë në pavarësinë e tyre.
- 1.2 Gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në asnjë aktivitet, ose të jenë anëtarë të ndonjë asociacioni, që do të mund të ndikonte në perceptimin dhe në besimin e qytetarëve në pavarësinë e tyre në vendimmarrje.

II. PAANSHMËRIA

- 2.1 Gjyqtarët duhet të ushtrojnë të gjitha përgjegjësitë në mënyrë të paanshme dhe duhet të sigurohen që kjo paanshmëri të vërehet në të gjitha veprimet.
- 2.2 Gjyqtarët duhet të kujdesen që të shmangin të gjitha konfliktet e interesit dhe duhet të përjashtojnë veten nga pjesëmarrja në çdo rast në të cilin mund të vihet në pikëpyetje anshmëria e tyre.
- 2.3 Gjyqtarët duhet të kryejnë të gjitha detyrat e tyre gjyqësore pa favorizime, pa anshmëri dhe pa paragjykime.
- 2.4 Gjyqtarët nuk duhet të lejojnë që mendimet ose interesat finaçiare personale të ndikojnë në mënyrë jo të duhur në shqyrtimin e tyre të drejtë të rasteve të paraqitura në Gjykatë.

III. INTEGRITETI

- 3.1 Sjellja e gjyqtarëve duhet të jetë gjatë tërë kohës në harmoni me karakterin e lartë moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit të Gjykatës.
- 3.2 Gjyqtarët duhet të dinë gjithmonë se sjellja e tyre personale dhe profesionale mund të ndikojë në respektin që kanë qytetarët për Gjykatën dhe duhet të sillen duke pasur në mendje rëndësinë e Gjykatës.
- 3.3 Gjyqtarët nuk duhet të pranojnë ndonjë dhuratë, përfitim, dekoratë, nderim apo shpërblim që do të mund të bënte që qytetarët të vënë në dyshim pavarësinë ose paanshmërinë e tyre.
- 3.4 Gjyqtarët nuk duhet të lejojnë që familja, të afërmit, zyrtarët qeveritarë apo personat e tjerë, në mënyrë të pavend të ndikojnë në ndonjë mënyrë në vendimmarrjen e tyre gjyqësore.
- 3.5 Gjyqtarët nuk duhet të lejojnë që opinionin publik, presioni, kërcënimet apo kritikën të ndikojnë në pavarësinë e vendimeve të tyre.

IV. AKTIVITETET JASHTËGJYQËSORE

- 4.1 Gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në aktivitete të tjera që nuk janë në përputhje me pavarësinë, me paanshmërinë dhe me kushtet e emërimit të tyre si gjyqtarë.
- 4.2 Gjyqtarët mund të ndërmarrin aktivitete që synojnë të përmirësojnë sistemin gjyqësor dhe administrimin e drejtësisë. Aktivitetet e tilla mund të përfshijnë mësimdhënien, ligjërimin ose shkrimin për tema që kanë të bëjnë me ligjin. Pjesëmarrja në aktivitete të tilla në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojë në kryerjen e detyrave gjyqësore, të cilat do të kenë përparësi ndaj të gjitha aktiviteteve të tjera. Gjyqtarët duhet të raportojnë me shkrim te Kryetari për të gjitha aktivitetet jashtëgjyqësore dhe t'i përmbahen nenit 5, paragrafi 4, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- 4.3 Gjyqtarët nuk duhet të jenë anëtarë të ndonjë partie ose organizate politike dhe nuk duhet të marrin pjesë në aktivitete politike.

V. KONFIDENCIALITETI

- 5.1 Gjyqtarët nuk duhet të zbulojnë informacionet e fshehta apo konfidenciale përkitazi me procedurat që janë duke u zhvilluar në Gjykatë.
- 5.2 Gjyqtarët duhet të respektojnë fshehtësinë dhe konfidencialitetin e të gjitha shqyrtimeve në Gjykatë.
- 5.3 Gjyqtarët nuk duhet të bëjnë komente publike ose të japin informacione për ndonjë rast, para se të vendoset për të dhe para se të publikohet mendimi i Gjykatës.

VI. LIRIA E SHPREHJES

- 6.1 Gjyqtarët duhet të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes në mënyrën e cila është plotësisht në përputhje me dinjitetin dhe me respektin e pozitës së tyre gjyqësore.
- 6.2 Në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes, gjyqtarët duhet të shmangin deklaratat publike apo komentet që mund të dëmtojnë autoritetin e Gjykatës dhe që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për paanshmërinë e gjyqtarit.

VII. BARAZIA

7.1 Në ushtrimin e përgjegjësive të tyre gjyqësore, gjyqtarët duhet të shmangin çdo anshmëri apo diskriminim në lidhje me ndonjë çështje të parëndësishme dhe duhet të trajtojnë të gjitha palët me respekt, me mirësjellje dhe në mënyrë të barabartë.

VIII. KUJDESI DHE KOMPETENCA

8.1 Gjyqtarët duhet të kryejnë me kujdes dhe me kompetencë detyrat në pozitën e tyre.

8.2 Gjyqtarët duhet të zhvillojnë vazhdimisht aftësitë dhe njohuritë e tyre profesionale, në mënyrë që të jenë në gjendje të mbajnë një nivel të lartë të kompetencës.

8.3 Gjyqtarët duhet të zgjidhin rastet me shpejtësi dhe me kohë, për të sjellë drejtësi për palët dhe për të ruajtur respektin për Gjykatën.

8.4 Gjyqtarët, për sa është e mundur, duhet të japin sqarime dhe arsytetime me shkrim për të gjitha vendimet.

8.5 Gjyqtarët duhet të informohen për zhvillimet e rëndësishme në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe nga jurisprudenca krahasuese, përfshirë edhe konventat ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera që përcaktojnë normat për të drejtat e njeriut.

8.6 Gjyqtarët duhet të punojnë së bashku në mënyrë kolegjiale dhe gjithmonë të tregojnë respekt maksimal për mendimin dhe për pikëpamjet e secilit gjyqtar.


8.7 Gjyqtarët duhet t'u drejtohen në mënyrë profesionale të gjithë punëtorëve të Gjykatës dhe duhet të sigurojnë që sjellja e punëtorëve të jetë në përputhje me këto udhëzime.

IX. ZBATIMI

9.1 Këto udhëzime nuk u japin ndonjë të drejtë palëve në ndonjë rast, apo qytetarëve, por janë miratuar si udhëzime dhe ndihmë për gjyqtarët në kryerjen e detyrave të tyre.

9.2 Kur një gjyqtar nuk është i sigurt për sa i përket interpretimit të ndonjërit prej këtyre udhëzimeve, gjyqtari mund të konsultohet me Kryetarin dhe, nëse është e nevojshme, me gjyqtarët e tjerë, për të ndihmuar në zgjidhjen e shqetësimit.

9.3 Ish-gjyqtarët duhet t'u përmbahen të gjitha dispozitave të këtij Kodi, kur është relevante dhe e zbatueshme.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani